



REPUBLIKA E SHQIPERISE
“UJESJELLES MAT” Sh.a.

Adresa : Lagja “Partizani”, Rruga “Ibrahim Temo”, Ndertesa Nr 6 ujesjellesmat.sha@gmail.com Tel : +355 217 22542

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për: Operatorin Ekonomik: **“ALIAJ-79” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **L47521901E**

Adresa: *Dibër, Lis, Zenisht, rruga “Ruçi”, ndërtesë private 1-katëshe përballë xhamisë.*

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozim - Mallra”** – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Numri i referencës së procedurës: **REF-88602-03-01-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje bazë materiale hidraulike dhe ndërtimi”**, me fond limit për shumatoren e çmimeve për njësi në vlerën: **71 401** (shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e një) **lekë pa TVSH**. Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 493 862** (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e UKM, me afat realizimi të marrëveshjes kuadër: **12** (dymbëdhjetë) **muaj**.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 34, datë 08 Mars 2021**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: **“ALIAJ-79” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **L47521901E**
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/ vlera: **71 016** (shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
2. Operatorin Ekonomik: **“ERVIN LUZI” P. Fizik**, me numër Nipt-i: **K71707007Q**
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **nuk ka ofertuar për shumatoren e çmimeve për njësi**.
Vlera e ofertuar: **1 444 000** (një milion e katërqind e dyzet e katër mijë) **lekë pa TVSH**

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: **“ERVIN LUZI” P. Fizik,** me numër Nipt-i: **K71707007Q**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, subjekti “Ervin LUZI” P. Fizik., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

- I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

“Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme sipas shtojcës 5 nuk është plotësuar pika 3 e deklaratës ku duhet të deklaronte se: *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ etj., nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.***

- II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

“a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)...”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në Formularin e Ofertës Ekonomike, nuk është ofertuar me çmimin/ vlerën për shumatoren e çmimeve për njësi të ofertës, sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në pikën 4.2 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të DST-së, duke qënë se procedura e prokurimit është “Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, në kundërshtim kjo me Udhëzimin Nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e Marrëveshjes Kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” të Agjensisë së Prokurimit Publik, duke qënë se A.K. kishte përcaktuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik bazuar në çmimin më të ulët për shumatoren e çmimeve për njësi të ofertës.**

- III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 2 (dy) punonjësish të punësuar, ndër të cilët 1 (një) shofer dhe 1 (një) punonjës për transportin e mallit, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqesë: Vërtetim lëshuar nga organet tatimore, listëpagesat e deklaruar përmes formës elektronike ku të jetë i specifikuar numri i punonjësve për çdo muaj, si dhe leje për drejtimin e mjetit kategoria B, të punonjësit me detyrë “shofer”.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në Vërtetimin (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin –E-SIG 02/a) nuk jepet informacion për numrin e punonjësve për muajin Janar 2021, si muaj i cili përfshihet në kërkesën e autoritetit kontraktor “...për periudhën 3 (tre) muajt e fundit...”.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

- Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Çertifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se Leja e qarkullimit të mjetit është fotokopje, në kundërshtim me kërkesën në DST, që “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre...”.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor një mostër për:

- *Niples xing*
 - *Manikotë*
 - *Izo PE*
 - *Bashkues PE*
 - *Tub PE*
 - *Fllanxa adapter*
 - *Reduksion*
 - *Ajrues PE*
 - *Saraçineskë levë bronxi*
 - *Fasheta riparimi dhe shërbimi PE*
 - *Reduksion xing*
 - *Brryl PE*
 - *Brryl xing*
- **Mosdorëzimi i mostrës për secilin material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s'kualifikim.**
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi u konstatua se, ditën e hapjes së ofertave (sipas përcaktimit në këtë pikë) nuk u paraqit për dorëzimin e mostrave për artikujt/ materialet e kërkuara objekt prokurimi.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operatorë ekonomik i suksesshëm:

1. Shoqëria: “**ALIAJ-79**” *Sh.p.k.*, me numër Nipt-i: **L47521901E**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **71 016** (shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë “**Ujësjellës Mat**” **Sh.A.** me adresë: *Rruga “Ibrahim Temo”, lagjja “Partizani”, Burrel, brenda 5 (pesë) ditëve* nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i draft marrëveshjes, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **24.03.2021**

Ankesa: Nuk ka patur.

Titullari i Autoritetit Kontraktor